



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-96  
Br.

Data 19.07.2023  
Datum

OBILIC OBILIC  
Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit nr. 03 / L-040, nenit 62 të Statutit të Komunës, thërras:  
Mbledhjen e Komitetit për Komunitete për dt. 25.07.2023, ( e martë ) në ora 11:00 me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë.
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Diskutim lidhur me prioritetet e projekteve kapitale që të përfshihen në planifikimin buxhetor për vitin 2024
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

  
Faton Beka





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-97  
Br.

Data 19.07.2023  
Datum

OBILIQ-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ  
Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete, të mbajtur me dt.23.06.2023 në ora 11:00 në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Faton Beka, Avdyl Mustafa, Florije Jashari, Haki Abazi, Biljana Spasic, Valbonë Beka, Sanela Mackic, Lulzim Preniqi dhe Predrag Micalovic

**Të pranishmit tjerë:** Besnik Salihu, zyrtar për buxhet dhe financa, Labearta Mjeku, zyrtare për kthim të qëndrueshëm, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Faton Beka, kryesues i Komitetit për komunitete, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

- 1.Arsyetimi për mungesë
- 2.Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 3.Informatë nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa lidhur me planifikimin buxhetor per vitin 2024, si dhe rishikimi i buxhetit
- 4.Të ndryshme

**Kryesuesi** – Pasi që jemi afër ditës së 24 qershorit, që është Dita e komunitetit egjiptian shfrytëzoj rastin përfaqësuesit të këtij komuniteti z.Haki Abazi, i uroj këtë ditë duke shpresuar se ky komunitet do të ketë një mirëqenie më të mirë.

Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua unanimitisht.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet unanimitisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Meqë drejtoresha e financave, për arsye shëndetësore sot nuk ka mund të merrë pjesë në mbledhje, këtu e kemi zyrtarin financiar i cili do të na njoftoj për planifikimin buxhetor për vitin 2024 si dhe për rishikimin e buxhetit.

**Besnik Salihu** – Siç e ceku edhe kryesuesi në mungesë të drejtoreshës, unë do ta prezentoj planifikimin e buxhetit për vitin 2024. Në total buxheti i parashikuar për vitin 2024 do të jetë 14 milionë e 248,389 euro.

Pjesë e kësaj është prej grandit të përgjithshëm 3 milionë e 438,000 euro, grandit specifik për Arsimin do të jetë 3 milionë e 171,000 euro, grandit specifik i shëndetësisë do të jetë 1 milionë e 383,500 euro. Gjithsejt prej grandeve do ti kemi 7 milionë e 993,000 euro. Gjithashtu, kësaj do ti shtohet edhe Ligji i Obiliqit, që është 5 milionë euro, për vitin 2024. Të hyrat vetanake, 1 milionë e 255,000 euro, të cilat parashihen të mbledhen që në total na jepin shumën paraprake 14 milionë e 248,839 euro. Prej total buxhetit siç është paraparë me u nda nëpër kategori ekonomike për paga dhe meditje do të jetë 5 milionë e 200,000 euro, të parapara për vitin 2024, mallra dhe shërbime do të shkojnë 1 milionë e 700,000 euro, shpenzime komunale do të jenë 380,000 euro, subvencione dhe transfere do të jenë 1 milionë e 100,000 dhe shpenzime kapitale do të jenë 5 milionë e 868,000 euro. Te shpenzimet kapitale shumica i adresohet ngrohjes qëndrore që është duke u krye për Obiliqin me fshatrat.

**Kryesuesi** – Më vjen mirë që secilën herë buxheti i Komunës së Obiliqit, po vjen duke u Rritur, duke pasë parasysh edhe një përqindje që na vjen prej KEK-ut, siç u përmendë që ishte 5 milionë euro dhe e di se ky buxhet do të shfrytëzohet për të mirën e të gjithë qytetarëve. Unë dua të di në sektorin e infrastrukturës, sa do të ndahet buxheti për shembull për rrugë, për kanalizim sepse kërkesat më të mëdha që ne po i kemi nga disa komunitete është se kanë mbetë disa rrugë pa u rregullue infrastruktura rrugore, duke përfshirë edhe k analizimin.

**Besnik Salihu** – Infrastruktura rrugore është një pjesë bukur e madhe e buxhetit që do të ndahet dhe në këtë drejtim është duke u punuar ende me drejtoreshën, por ende nuk kemi të dhëna të sakta, pasi që ende nuk është përpiluar defenitivisht buxheti. Ne jemi duke i ndarë nëpër të gjitha Drejtoritë projektet e veçanta, ashtu qysh janë për atë edhe me shifër të saktë nuk mund të tregoj, por është rritje bukur e madhe në krahasim me këtë vit dhe vitet e mëhershme.

**Kryesuesi** – Po, ju kuptoj se ende është koha e planifikimit që deri në shtator të votohet në Kuvend dhe të dërgohet në Ministri. Më vjen mirë dhe shpresoj se edhe përmes dëgjimeve publike, që i keni organizue do të përshihen shumica e atyre kërkesave që ne i kemi përmendë. Unë e di se pjesa më e madhe e buxhetit do të shkoj për ngrohje qëndrore, që është një projekt ku do të përfitojnë të gjithë.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Avdyll Mustafa** – Unë i uroj të gjithë komunitetit egjiptian Ditën kombëtare të këtij komuniteti duke i dëshiruar shumë sukses në vitin e ardhshëm.

**Kryesuesi** – Unë e kam bërë një kërkesë në Drejtorinë e infrastrukturës, dhe para 2 mbledhjeve ka qenë prezentë drejtori i infrastrukturës, të cilin e falënderoj shumë për bashkëpunimin e mirë që e kemi me z.Fatmir Bërbatovci. Unë kërkesën e kam bërë për fshatin Plemetin për rrugën “Bregaj” segmenti i parë që kam kërkuar është të rregullohet rruga, kanalizimi dhe ujësjellësi. Drejtori na ka dhënë informata se nëse, e shohin të arsyeshme kanë mundësi që këtë projekt me sjellë në këtë vit, e nëse jo mbetet për vitin e ardhshëm. Po ashtu, e kam bërë edhe një kërkesë për fshatin Palaj, rruga që shpie te Ari i zi, që një pjesë nga shkolla deri te fshati të shtrohet me trotuar, pasi që ajo pjesë frekventohet me mjete të rënda të KEK-ut, kështu që iu kanoset rreziku dhe iu vështirësohet lëvizja e atyre banorëve. Unë kam kërkuar që të bëhet me trotuar dhe kam marrë fjalën nga drejtori se vitin e ardhshëm do të kryhet. Përgjegjen me shkrim e kemi marrë, do të thotë në mënyrë të përgjithshme, që nëse, nuk mund të përfshihet gjatë këtij viti do të planifikohet për vitin 2024. Ne do ti ndjekim hapat e mëtejme që para se të miratohet buxheti në shtator ti pëfshijmë kërkesat tona. Unë i ftoj dhe kërkoj nga anëtarët e Kuvendit për çdo pikë apo kërkesë që e kemi të ndihmojnë dhe ti shtyjme proceset përpara.

**Sanela Mackic** – Pre svega, cestitam i ja Dan zajednice egipcana, i zelim sve najbolje. Htela bih da vas pitam jer ste vi proslje sednice pomenili kosenje groblja na teritoriji Opstine Obilic, sta ste uradili povodom toga iz razloga blizi se Bajram i svi mislim ulaze tog dana na Groblje, svojim najmilijima i porodicama. Ako imate neku informaciju, mene konkretno zanima groblje u Mazgitu, ali pitam i za sva ostala groblja na teritoriji Opstine Obilic.

**Kryesuesi** – Unë e kam një informatë dhe para 2 dite kam biseduar me drejtorin e kompanisë pastrimi “Kastrioti” për pastrimin e varrezave. Sipas tij tha se ne kemi marrëveshje me Komunën dhe kemi filluar heqjen e barit të të gjitha rrugëve dhe gjithashtu, të gjitha varrezat e qytetit dhe të fshatrave janë në

procedurë dhe janë duke u pastruar.

**Predrag Micalovic** – Posto, g.Hakiju nije tu ja bih cestitao Dan egipcana. Prvo, sto bih hteo da kazem dosta stvari sto ste vi rekli presedavajuci 80 %, jeste sto sam ja hteo da kazem sto se tice nekih stvari nasih probleme koji treba da se resavaju. Da li se uopste ima svrhe iznositi ako se ne desavaju i nadam se da verovatno u Skupstini da sve to obrazlozite, da ima ipak neke svrhe koje mi ovde kazermo bar jedan, bar neki mali problem bude resen koje mi predlozimo. Do sada nisam primetio da ni jedan bar pomak napravio nekih problema, mogu da ih nabrojim.Konkretno na primer za Babin Most, sada cu da pricam, posto katastrofa je bila zadnje kise koje su bile, ali nisu prve znaci ovo je vec drugi i treci slucaj, gde su poplave ne znam na kom stepenu. Celo polje je poplavljeno i to su neki prioritetni problemi koji poljoprivrednici Babinog Mosta, oni koji su nesto posejili to je sve propalo. Oni koji su mislili da seju konkretno mislim sada na cime ljudi zive, to je paprika najvise u Babinom Mostu i drugi, znaci nema sanse da pocnu da seju, zato sto je to kao jezero polje u Babinom Mostu.To, ne znam da li neko uopste zna, medjutim ima problema i u Plemetini koliko sam video i koliko je to tamo ne znam gde su ljudi privatno otvarali korito da ne bih njima, pa su onda pustali na druga mesta da ide. Ne znam koliko je to sada za ovde da se to prica, ali ljudi od toga zive i nerma sanse da se sada to nesto uradi. Znaci, sve ono sto su pripremali i rasadi i njive ulozili sredstva u mineralna djubriva, i to je sve propalo. Mi jesmo pisali ovde u Opstini, sektor poljoprivrede zahtev za pomoc neku nadoknadu stete, da li ce to Ministarstvo da razmatra ili ne ne, znam ili Opstina, ali nadamo se da hoce. Znaci, pogotovo posledica izlivanja reka to je jedna zob okrecina, znaci vi necete da verujete polje celo smrdi i tu moze da dodje do raznih infekcija i mogu da se stvore razne epidemije.Ja bih zamolio oni koji su tu i koji su clanovi Skupstine, da iznesete to i ako moze da se to resi jer ljudi koji nisu bas imucni od toga zive, i ove godine ostati bez hleba, fakticki nece imati od cega da zive, jer od toga zive.Trenutno ne postoji mogucnosti da u Babinom Mostu, nesto uradi od te vode, i Komisija moze da dodje na licu mesta da se uvere, ali bih bilo dobro na sledecoj Skupstini, da se to iznese da se drugi put to ne desava. Ima i drugih problema, ali mislim da trenutno jeste to prioritet i broj jedan, ako je nesto moguće da se bilo sta uradi, jer ljudi nemaju mogucnosti da seju, ostace tako.

**Kryesuesi** –E kuptoj shqetësimin tënd dhe të gjitha ato që i përmende. Unë thashë se duhet ta kemi një bashkëpunim në mënyrë që ti shtyjme proceset duke i falënderuar anëtarët e Kuvendit, të cilët këtu i kemi prezentë. Sa i përket vërshimeve, jo vetëm në Komunën tonë por në tërë territorin e Kosovës, ka vërshime. Ju e cekët se keni bërë kërkesë me shkrim te organet gjegjëse në Komunë dhe ne mund të takohemi me zyrtarët komunal dhe drejtorët që me iu kompenzue ajo pjesë. Shpresoj dhe besoj se organet gjegjëse dhe ekipet emergjente, do të dalin në terren pa marrë parasysh nacionalitetin sepse edhe në të kaluarën e kanë bërë një gjë të tillë.

**Avdyl Mustafa** – Ja bih izrazio svoje zaljenje za sve porodice koje su pretrpele stetu od ovih poplava i slozio bih se sa g.Predragom, o tome da se ovo pitanje raspravlja. To jest, da clanovi Skupstine da razgovaraju o ovom pitanju u sednici Skupstine i cisto njihove zahteve odobre.Ja sam uveren da Opstina, radi na tom pitanju i verovatno oni naci ce resenje za nadoknadu stete. Ali da bude sigurni da ce se to realizovati bilo bih dobro da ovo pitanje predlazu i diskusiju otvare u sednici Skupstine.

**Kryesuesi** – Propozoj të marrim një rekomandim lidhur me këtë çështje dhe ky rekomandim të shkoj në Kuvend.

Pas diskutimeve anëtarët e Komitetit për komunitete unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal që të shqyrtohet mundësia e kërkesës së atyre banorëve për kompensim të dëmeve materiale nga vërshimet.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:30'**

**Procesmbajtësja**

  
**Azize Zeneli**

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete**

  
**Faton Beka**

